



Me qëllim implementimin e aktiviteteve të parashikuara me Programin për aktivitetet nga fusha e mbrojtjes sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore, në qytetin e Shkupit për vitin 2026 ("Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit" numër 14/25), Qyteti i Shkupit shpall

THIRRJE PUBLIKE
për përkrahjen e projekteve dhe aktiviteteve programore
të organizatave që punojnë në fushën e mbrojtjes sociale,
të fëmijëve dhe shëndetësore

1. Lënda e Thirrjes publike

1.1 Lënda e Thirrjes publike është mbledhja e ofertave për mbështetje financiare të projekteve dhe aktiviteteve programore të shoqatave civile, organizatave, fondacioneve dhe subjekteve të tjera që punojnë në fushën e mbrojtjes sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore.

1.2 Projektet dhe aktivitetet programore do të mbështeten me mjete nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2026, dhe në përputhje me Programin për aktivitete në fushën e mbrojtjes sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore në qytetin e Shkupit për vitin 2026 si dhe në bazë të kriterëve dhe prioritetëve të dhëna në këtë Thirrje publike.

1.3 Mënyra e shfrytëzimit të mjeteve për vitin 2026 do të rregullohet me kontratë ndërmjet organizatës dhe Qytetit të Shkupit.

2. Projekte të cilat do të mbështeten:

Në suazat e Thirrjes publike, projektet që do të mbështeten me mjete financiare nga ana e Qytetit të Shkupit, duhet të kenë lidhje me:

- 2.1 Mbështetje e programeve dhe projekteve, shërbimeve dhe qendrave ditore për fëmijë në rrugë, fëmijëve pa prindër dhe kujdes prindëror, fëmijëve në rrezik social, familjeve me prind të vetëm, parandalimit të dhunës në familje, personave që përdorin drogë, personave me aftësi të kufizuara, personave me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç, persona me sjellje të spektrit autik, personave me sëmundje të rralla, personave të pastrehë, të moshuarve dhe të tjerë;
- 2.2 Përmirësimi i kujdesit shëndetësor dhe mbështetja e serviseve dhe shërbimeve shëndetësore;
- 2.3 Mbështetje e aktiviteteve të qendrave ditore dhe të këshillimit për viktimat e dhunës në familje;
- 2.4 Mundësi të barabarta, mosdiskriminim, inkurajim dhe zhvillim i vlerave personale dhe shoqërore;
- 2.5 Përfshirja shoqërore dhe shërbime sociale për kategoritë e qytetarëve në nevojë;
- 2.6 Mbështetje për organizatat që punojnë në fushën e sipërmarrjes sociale me qëllim punësimin e grupeve sociale të përjashtuara ose të cënueshme.

3. Kritere themelore

Kriteret themelore të cilat duhet t'i plotësojnë organizatat të cilat marrin pjesë në këtë Thirrje publike janë:

- 3.1 Të jenë të regjistruara sipas Regjistrisë Qendrore të RMV-së;
- 3.2 Të merren me aktivitete dhe projekte me interes publik për minimum dy vite;

4. Dokumentacioni i detyrueshëm për aplikim

- 4.1 Aplikimi për mbështetjen financiare të organizatës, i nënshkruar dhe vërtetuar me vulë nga personi i autorizuar (në dispozicion në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk);
- 4.2. Formulari i plotësuar për propozim-projektin (në dispozicion në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk);
- 4.3 Statuti i Organizatës;
- 4.4 Aktvendimi për regjistrimin e organizatës i lëshuar nga Regjistri Qendror i RMV-së;
- 4.5 Fotokopje nga llogaria përfundimtare për vitin e kaluar fiskal;
- 4.6 Vërtetim për pagimin e tatimeve të lëshuar nga organet tatimore.

VËREJTJE: Aplikimet të cilat nuk përmbajnë dokumentacionin e plotë të detyrueshëm nuk do të shqyrtohen më tej.

5. Dokumentacioni shoqërues:

Organizatat të bashkëngjitur mund të depozitojnë edhe këto dokumente shoqëruese:

- 5.1 Biografi profesionale e ekspertëve që do të angazhohen në realizimin e projektit;
- 5.2 Listë referimi ose dëshmi (për shembull: kontratë e nënshkruar) për së paku 2 projekte të realizuara në fushën për të cilën aplikojnë;
- 5.3 Së paku 2 mendime (referenca) nga partnerë ose donatorë për realizimin e projekteve të mëparshme;
- 5.4 Përkrahje me shkrim nga organizata të tjera dhe/ose institucione për të cilat është planifikuar që të marrin pjesë në realizimin e projektit.

6. Mënyra e zbatimit të Thirrjes publike:

- 6.1 Për të përcaktuar përmbushjen e kriterëve nga Rregullorja për mbështetjen financiare të projekteve dhe aktiviteteve programore të organizatave që punojnë në fushën e mbrojtjes sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore dhe nga kjo Thirrje Publike, kryetari i Qytetit të Shkupit formon Komision për zbatimin e procedurës për alokimin e mjeteve për mbështetjen e projekteve dhe aktiviteteve programore të organizatave që punojnë në fushën e mbrojtjes sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore.
- 6.2 Aplikimi me dokumentacionin e kërkuar depozitohet në një ekzemplar origjinal, të plotësuar në mënyrë elektronike, të nënshkruar dhe të vërtetuar nga personi përgjegjës i organizatës.
- 6.3 Për aplikimet e plota, të depozituara në kohë dhe që plotësojnë kriteret në përputhje me Rregulloren dhe këtë Thirrje Publike, Komisioni depoziton propozim pranë kryetarit të Qytetit të Shkupit për alokimin e mjeteve financiare për aplikantët.

6.4 Me propozimin e Komisionit, kryetari i Qytetit të Shkupit miraton aktvendim për alokimin e mjeteve financiare.

6.5 Komisioni nuk do të shqyrtojë aplikimet e depozituara me vonesë, aplikimet e depozituara me e-mail dhe aplikimet e plotësuara me shkrim dore.

6.6 Komisioni do të njoftojë aplikantët, aplikimet e të cilëve janë pranuar dhe aplikantët, aplikimet e të cilëve janë refuzuar si të paplota, të depozituara me vonesë dhe që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në Rregullore dhe Thirrjen Publike.

7. Afati dhe mënyra e depozitimit të aplikimeve

7.1 Afati i fundit për depozitimin e aplikimeve është deri më 12.02.2026, deri në orën 15:00.

7.2 Aplikimet me dokumentacionin e plotë depozitohen në arkivin e Qytetit të Shkupit, baraka 16 (me shënimin - Sektori për veprimtari shoqërore, Seksioni për mbrojtje sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore - Aplikim për Thirrje publike) ose nëpërmjet postës në adresën: Qyteti i Shkupit, Sektori për veprimtari shoqërore, Seksioni për mbrojtje sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore, bul. "Ilindenska" nr. 82 1000 Shkup. **Aplikimet e depozituara me e-mail nuk do të shqyrtohen.**

7.3 Aplikimet për mbështetjen financiare të organizatave, si dhe Formulari për propozim–projektin janë në dispozicion në ueb-faqen e internetit të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk.

7.4 Aplikantët në Thirrjen publike do të informohen për rezultatet në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të aktvendimit për alokimin e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2026.

Vërejtje: Aplikimet pa dokumentacionin e plotë të bashkëngjitur ose të depozituara pas skadimit të afatit të parashikuar nuk do të shqyrtohen! Bashkëngjitjet e depozituara nuk kthehen.

Për informacione plotësuese:

Pyetje për sqarime plotësuese mund të depozitohen në formë të shkruar ose elektronike pranë Seksionit për mbrojtje sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore.

Kontakt: Seksioni për mbrojtje sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore, tel: 02/ 3297 278 ose 02/ 3297-321 ; E-mail adresa: socijala@skopje.gov.mk.